



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA  
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA  
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË / MINISTARSTVA ZDRAVSTVA / MINISTRY OF HEALTH**

Bazuar në nenin 67, 68, 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 06/L - 114 Për Zyrtar Publik, Ministria e Shëndetësisë shpallë konkurs publik:

**SHPLLJA E KONKURSIT**

<b>Institucioni:</b>	Ministria e Shëndetësisë
<b>Departamenti:</b>	Departamenti Shëndetësor i Burgjeve
<b>Titulli i punës:</b>	Psikolog, Njësia Shëndetësore të Burgut në Prizren (1 pozitë)
<b>Koeficienti:</b>	H – 628 - (628.00 euro)
<b>Raporton te:</b>	Udhëheqësi i Njesisë Shëndetësore në Burg
<b>Orari i punës:</b>	40 orë në javë (orar të plotë)
<b>Kohëzgjatja:</b>	Me kohë të pacaktuar
<b>Nr. i Referencës:</b>	MSh-02/08/2022

1. Punon në bashkëpunim të ngushtë me Udhëheqësin e Njesisë Shëndetësore të Burgut dhe është nën mbikëqyrjen administrative të tij;
2. Bashkëpunon ngushtë me Psikiatrin dhe të mbanë përgjegjësi të plotë profesionale drejtpërdrejt te Psikologu Koordinator;
3. Është përgjegjës për shërbimin psikologjik për institucionin që është i ngarkuar;
4. Bën vizita të rregullta për të gjitha rastet në praninë dhe jep vlerësimin psikologjik sipas pyetësorëve dhe instrumenteve të përcaktuara dhe aprovuara;
5. Trajton të gjitha rastet specifike në mënyrë të drejtpërdrejtë;
6. Trajton të gjitha rastet me probleme serioze si: çrregullime psikologjike, probleme emocionale, tentim të vetëvrasjes etj;
7. Trajton dhe mbikëqyr të gjitha rastet që janë përdorues të duhanit, alkoolit, drogave etj;
8. Përgatit raporte të punës për Mjekun Përgjegjës të Burgut, Drejtorin e Burgut, Psikologun Koordinator, Drejtorin Shëndetësor, Drejtorin Korrektues, autoritetet gjyqësore etj;
9. Përgatit raporte psikologjike për Komisionin për Lirim me Kusht;
10. Përgatit raporte psikologjike, dhe paraqet raste për Komisionin Multidisciplinar të Udhëheqësi të NJSHB, Psikologu Koordinator dhe Drejtori i Burgut në bashkëpunim me konsulltantin Psikiatër;
11. Jep këshilla psikologjike për të gjitha rastet specifike për udhëheqësit e institucioneve dhe Mjekun Përgjegjës të Burgut
12. Te jete i gatshëm edhe për detyra tjera shtese në rrethana specifike dhe sipas nevojës.

**Shkollimi i kërkuar:** Specialist i Psikologjisë Klinike, ose në mungesë të Specialistit, Diplomë universitare Master i Psikologjisë Klinike.

**Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:**

- Aftësi të mira në koordinim, komunikim komunikim ndër personal;
- Aftësi për të komunikuar dhe shpjeguar çështjet komplekse teknike në mënyrë të thjeshtë dhe të qartë;
- Njohuri dhe shkathtësi të mira të punës me kompjuter, në përdorimin aplikacioneve word dhe excel, përdorimin e internetit dhe baza të dhënave;
- Njohje shumë e mirë e mirë gjuhëve zyrtare të Republikës së Kosovës, të folur dhe me shkrim, dhe njohurit në gjuhën angleze janë përparësi.

**Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:** Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar. Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

**Data e publikimit të konkursit: 12/08/2022**

**Afati për aplikim: 10/09/2022 deri 18/09/2022**

**Paraqitja e kërkesave:** Aplikacionet merren në faqen zyrtare të Ministrisë dhe dorëzohen në zyrën nr. 23 të Ministrisë së Shëndetësisë, Lagja Arbëria, rruga e Zagrebit Nr..60 (ish Spitali i mushkërive).

Në aplikacion duhet të cekët qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës.

Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.